



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: HISTORI E POPULLIT SHQIPTAR

<i>Pedagogu:</i>	Departamenti i Historisë/ FHF
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Programi i studimit:</i>	Bachelor, gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	I/I

Shkurtesë: Kjo lëndë trajton problemet e lashtësisë të popullit shqiptar. Banorët e lashtë. Formimi i etnosit ilir. Ilirët autoktonë në trojet e tyre. Formimi i shtetit ilir. Luftrat iliro-romake. Iliria nën sundimin romak. etj.

Temat e leksioneve:

1. **Etnogjeneza e Ilirëve.** Pikëpamjet në historiografi mbi etnogjenezën e ilirëve. Përbërësi kulturor autokton dhe raportet e tij me elementin e ardhur.
2. Roli i dyndjeve indoevropiane dhe panono-ballkanike në etnogjenezën e ilirëve. Problemi pellazg.
3. Kufijtë e ilirëve dhe topografia e fiseve kryesore.
4. **Mbretëritë Ilire.** Mbretëria ilire. Kufijtë e saj. Organizimi social dhe politik, marrëdhëniet me jashtë
- 5.. Mbretërimi i Bardhylit, Klitit dhe Glaukias.
6. Mbretëria epirote. Etniciteti dhe territori. Fazat e zhvillimit politik dhe karakteristikat e tyre. Mbretërimi i Tharypës, Aleksandrit dhe Pirros.

7. **Luftrat iliro-romake.** Shkaqet e luftrave.
8. Zhvillimi dhe pasojat e luftës I, II dhe III iliro romake. Pushtimi i viseve të tjera ilire nga Roma.
9. Kryengritjet ilire. Kryengritja e madhe e viteve 6-9 e.s.
10. **Iliria dhe perandoria romake.** Organizimi administrativ i Ilirisë. Kufijtë e provincave. Rrjeti rrugor.
11. Kontributi i ilirëve në Perandorinë Romake. Perandorët me origjinë ilire. Pikëpamjet lidhur me romanizimin e ilirëve.
12. Ilirët dhe krishterimi. Dyndjet barbare në Iliri dhe pasojat e tyre. Ilirët dhe Perandoria Romake e lindjes.
13. **Kultura ilire dhe ekonomia.** Kultura ilire në periudhën prehistorike.
14. Zhvillimi i jetës qytetare. Qytetet kryesore dhe veçoritë e tyre. Arkitektura dhe Arti. Kultura në Iliri në periudhën romake.
15. Gjuha ilire dhe besimi. Bujqësia, blegtoaria, zejtoaria dhe tregtia.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	80% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura bazë:

1. Historia e popullit shqiptar "volumi I".